



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 2
Prishtinë, më 23.03.2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Shaip Muja, Skender Hyseni, Sabri Hamiti, Donika Kadaj-Bujupi dhe Amir Ahmeti, ndërsa mungoi Petar Miletic.

Nga pjesëmarrësit e tjerë: Amir Haradinaj – ZPRK, Besnik Ramadani – KDI dhe Sanije Berisha – OSBE.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Elfete Alshiqi - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

1. **Miratimi i rendit të ditës**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 18 marsit 2011,**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës, lidhur me buxhetin e Ministrisë së Punëve të Jashtme,**
4. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Albin Kurti e propozoi miratimin e rendit të ditës.

Shaip Muja - Lidhur me rendit të ditës, propozoi që pika e tretë të shtyhet për shqyrtim, sepse nuk është i ftuar ministri i Punëve të Jashtme. Ceku se për këtë takim kishte qenë më mirë, të ftohej zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, që ta njoftonte Komisionin për bisedimet.

Lidhur me rendin e ditës, përkatësisht për pikën e Shqyrtimin e Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës lidhur me buxhetin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, diskutuan deputetët: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Sabri Hamiti, Shaip Muja dhe Donika Kada-Bujupi .

Komisioni pas diskutimeve për rendin e ditës konstatoi:

Miratohet rendi i ditës i propozuar për mbledhjen e 23 marsit 2011.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 18 marsit 2011

Njëzëri u miratua procesverbali i mbledhjes së 18 marsit 2011.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës lidhur me buxhetin e Ministrisë së Punëve të Jashtme

Albin Kurti - Projektligji për Buxhetin do të shqyrtohet në procedurë të përshpejtuar, prandaj është parë e arsyeshme në cilësi të Komisionit të interesuar të shqyrtohet buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme. Në vazhdim shtoi se nuk ka mjaft hollësi për të bërë analiza të mjaftueshme, por vërehet, krahasuar me buxhetin e vitit të kaluar, se buxheti i propozuar ka një rënie nga 26 milionë në 18 milionë. Ko ndoshta është e arsyeshme, sepse vitin e kaluar janë blerë më shumë objekte për ambasada.

Buxheti ka mospërputhshmëri midis ndarjes së mjeteve për ambasada dhe atyre të Ministrisë, nga i cili buxhet prej 18.4 milion euro, 15.7 milionë euro janë dedikuar për ambasada e tjerat për shërbime të administratës qendrore. Ndarja e buxhetit për ambasada, në kategorinë paga e mëditje, nga 3.25 milionë euro sa ka e gjithë Ministria, 2.6 milionë euro ndahen vetëm për paga e mëditje të ambasadave, që duhet trajtuar në njërin nga mbledhjet e radhës me ministrin. Shtrohet pyetja, sa është paga e ambasadorëve, a merr mëditje ambasadori e stafi i tij, deri sa shërbejnë në mision?

Mospërputhshmëria midis shumës së planifikuar në korrik të vitit 2010 për blerjen e objekteve të ambasadave, që në vitin 2010 ishte 7.4 milionë euro, kurse kjo shumë në vitin 2011 ka rënë në 4 milionë euro, është çështje tjetër, që duhet sqaruar se pasojë e kujt është. Ndarja e kategorive buxhetore për ambasada, për mallra e shërbime 8.2 milionë euro, kurse për investime kapitale 4 milionë duhet sqaruar.

Proporcioni i buxhetit për mallra dhe shërbime është shumë më i madh në krahasim me ministrinë e tjera. Kategoria për investime kapitale për ambasada, duhet parë në hollësi se çfarë përfshijnë këto investime.

Me ndarjen e buxhetit si për Ministri ashtu edhe për ambasada po mungon një lloj serioziteti dhe profesionalizmi në emërtimin e kategorive. Shumica e mjeteve janë të bartura nga viti 2010, që lënë përshtypjen e një buxheti të mbijetesës e jo të një buxheti progresiv. Gjithashtu thuhet se Ministria e ka ndryshuar qasjen ndaj lobimit për njohje të reja. Ne duhet ditur si duket kjo qasje e re dhe a ka implikime buxhetore, si dhe ta shohim mundësin e ndihmës së Komisionit në çështjen e politikës së jashtme në koordinim me Ministrinë. Komisioni duhet ta ketë organogramin e Ministrisë, për të parë sa është Ministria e aftë për nga struktura, për t'u ballafaquar me detyrat, për të cilat është e ngarkuar, sepse kuadri i ekspertëve është shumë i rëndësishëm në Ministri dhe i nevojshëm për një shtet të pavarur, përveç çështjeve materiale të Ministrisë. Në programin qeveritar do të duhej sa më parë t'i kualifikojmë temat, që janë përshkruese në këtë program, përkitazi me afatet kohore, punës, vëllimit të punës, angazhimit dhe rezultateve që do të vijnë.

Skënder Hyseni – I njoftoi lidhur me çështjet që u ngritën nga kryetari i Komisionit rreth ambasadave, pagave të ambasadorëve dhe kushteve që i përcjellin ata gjatë punës. Konsideron se kushtet e ambasadorëve janë pasqyrë e shtetit dhe duhet ruajtur dinjitetin e tyre.

Sa i përket buxhetit tha se është shqetësues fakti se buxheti i propozuar është i përgjysmuar nga propozimi i bërë në muajin shtator, ku ishte i propozuar një buxhet prej 36 milionë eurove. Buxheti i propozuar prej 18 milionë euro për vitin 2011 është shumë i vogël.

Donika Kada Bujupi - Konsideron se ky buxhet i propozuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme, shihet si një buxhet shpenzues e jo zhvillues. Duke pasur parasysh ankesat për kushtet e punës së misioneve, kërkoi që për mjetet e ndara për ambasada veç e veç të njoftohet Komisioni.

Skënder Hyseni - Tha se ka ankesa të vazhdueshme nga misionet, por çështjet duhet shikuar në lidhshmëri me dispozitat në fuqi që e rregullojnë këtë materie.

Amir Ahmeti - Mendon se prania e ministrit të Jashtëm dhe ministrit të Financave do ta bënte më të lehtë identifikimin e këtyre shifrave buxhetore për Ministrinë e Punëve të Jashtme, sepse nuk e dimë sa ka pasur buxhet secili dikaster vitin e kaluar. Nga një takim i mëparshëm me ministrin e Jashtëm, njoftoi se ka informatë se këtë vit është paraparë një buxhet më i vogël, sepse nuk përfshihet blerja e ambasadave, përveç blerjes së objektit të ambasadës në Bruksel, ndërsa në të gjitha dikasteret e tjera ka rritje të buxhetit.

Sabri Hamiti - Thekson se çështja e trajtimit të kësaj pike në Komision ka qenë e domosdoshme. Për këto çështje buxhetore është e mundshme të kërkohej sqarime në seancë. Propozon që ky dikaster të forcohet materialisht, sepse pjesa diplomatike nuk bënë të dëmtohet për shkak të mjeteve materiale.

Shaip Muja - Tha se ekziston një konsensus i përbashkët që kjo Ministri të përkrahet materialisht. E përkrahu mendimin se në planin global përfaqësimi i korit diplomatik në botë të mbulohej financiarisht me gjithë infrastrukturën përcjellëse që i nevojitet. Është e nevojshme që të përqendrohem në politikën e jashtme, se çka mund të kontribuojmë si Komision.

Komisioni është i nevojshëm të ketë njohuri për punën e Ministrisë, të ftohet zëvendëskryeministrja Edita Tahiri që të njoftojë për bisedimet, po ashtu do të mund të ftohej edhe ministri i Sportit që të njoftojë për pengesat e integritetit të sportit kosovar në FIFA.

Skënder Hyseni – Lidhur me çështjen e ngritur të kuadrove shtoi se forcimi i kuadrove është i vështirë të bëhet me paga të ngjashme si në çdo ministri tjetër.

Hydajet Hyseni - Mendon se po të ishte i pranishëm ministri do ta lehtësonte punën e Komisionit. E përkrah rritjen e shtesës financiare të buxhetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Albin Kurti - Konstatoi se është qëndrim i Komisionit të rritet buxheti i MPJ-së, të ketë më tepër specifikacion tek linjat buxhetore, si dhe të ketë më shumë investim në aftësimin e kuadrove për përfaqësim sa më të mirë në arenën ndërkombëtare dhe për mbrojtjen e interesave të qytetareve të Kosovës, kudo që janë ata.

Komisioni pas diskutimit të deputetëve: Sabri Hamiti, Skënder Hyseni, Hydajet Hyseni dhe Donika Kadaj-Bujup e nxori këtë:

Përfundim

I rekomandohet Komisionit për Buxhet dhe Financa ta shikojë mundësinë e rritjes së buxhetit të Ministrisë për Punë të Jashtme për vitin 2011.

4. Të ndryshme.

Albin Kurti - Njoftoi se ka arritur Strategjia legislative e Qeverisë për vitin 2011. Sipas Strategjisë do të vijë për shqyrtim edhe Projektligji për marrëveshjet ndërkombëtare, ndërsa Komisioni për Punë të Jashtme do të duhej të jetë komision funksional për shqyrtimin e tij. Shqyrtimi i këtij projektligji do të parashihet në planin e programin e punës së Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti